REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/678
24/06/2025

# Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Vojnovc

E mërkurë, më 18 qershor 2025
Kohëzgjatja e takimit: 19:30 –21:15
Vendi i takimit: SHMFU ''Lasgush Poradeci''

Të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Asamblesitja – Sanie Sadiku

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028**

**Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu:** Përshëndetje për të gjithë, faleminderit shumë që keni ndar kohën dhe ju keni përgjigjur ftesës tonë për të qenë në këtë dëgjim publik të cilin e organizojm në kuadër të draftimit të buxhetit për vitin 2025-2026. Siç e dini është hera e katërt, prej që jemi në këtë detyrë, dhe zakonisht mundohemi të shkojm në secilin vendbanim në mënyr që buxheti me qenë sa më i drejtë dhe sa më proporcional i shtrit në të gjitha vendbanimet, prandaj jemi këtu.
Qarkorja e parë nis tani në muajin qershor, mblidhen të gjitha kërkesat, nevojat, prioritetet dhe zotimet të cilat i kemi dhënë, këto komponenta më vonë e bëjnë buxhetin, votohet në shtator më pas bëhet projektimi i projekteve dhe në pranverën e ardhshme fillon implementimi i tyre. Komuna e Shtimes këtë vit e ka dikun buxhetin 11.5 milion, ne e kemi gjetë 7.8 milion euro, tash ka arrit deri 11.5 milionshi kjo fal financimit më të mirë që po e bënë qeveria, po ndan grante për komunat më shumë, por edhe në performancë të mirë në mbledhjen e taksave në nivel qëndror.
Megjithatë edhe pse janë 11.5 milion euro për komunën janë pak, diku përmbi 50% e këtij buxheti shkon për paga dhe mëditje, pjesa tjetër pastaj mbetet për investime kapitale, mallra dhë shërbime , subvencione si dhe komunali.
2.5 milion euro janë investime kapitale për të cilat më shumë flitet në këto takime. I kemi 22 vendbanime, përveq qytetit i kemi edhe 21 fshatra ku në mesin e tyre është edhe fshati Vojnovc. Ne na ka buzëqeshequr fati sepse për këto tre vite ju e keni parë që ne kemi punuar jemi angazhuar kemi bërë projekte po edhe kemi gjetur mbështetjen e qeverisë qendrore.

Kryeministri Kurti dhe ministrat e kësaj qeverie na kanë përkrahur me shume projekte dhe na e kanë mundësuar atë të cilën ne qysh në fillim kemi dashur ta bëjmë, Shtimen urbane.
Tani që po flasim, mos ma merrni për te keq nuk është këtu koha për t'i thurur lavdata vetës, por diku për kto tre vite e gjysëm mbi 55 milion euro janë ardhur në drejtim të Shtimes, janë projekte të cilat janë nisur, disa të tjera janë në proces e disa edhe kanë përfunduar.
Tani unë po ua kaloj fjalën juve që t'i bëni kërkesat e juaja, secili nga ju mund të shtroj një prioritet të cilën e keni qoft në familje, lagje apo në emër të fshatit.

Kërkesat e banorëve:

- **Nexhmedin Mehmeti:** Rregullimi i shkollës
- **Basri Aliu:** Të bëhen kanale për kullimin e tokave.
  Sa i përketë emërtimit të rrugëve, rruga jonë nuk ka emër edhe po ashtu është pa numër, çfarë duhet të bëjmë?
- **Albert Ramadani:** Dy apo tre pika të ujit t'i kemi në raste se ndodh ndojë zjarr apo diçka. (Të ketë hidrantë)
- **Smajl Salihu:** Ndriçim në rrugën"Jashari", gjithashtu rivitalizimi dhe zgjerimi i po kësaj rruge.
- **Sead Shabani:** Për një sallon të pames kemi nevojë si fshat.
- **Shefki Mehmeti:** Të vendoset një shenjë që nuk lejohet të kalohen mjetet mbi 7t.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Vojnovc
Date: 18.06.2025

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | BASRI ALIU | |
| 2 | Fehmi Salihu | |
| 3 | Albert Ramadani | |
| 4 | Nexhmedin Mehmeti | |
| 5 | Fazullah Fazullahu | |
| 6 | SHEFKI MEHMETI | |
| 7 | Bleron Alija | |
| 8 | Arbën Aliu | |
| 9 | Abdylmexhid Abedini | |
| 10 | Albin Abedini | |
| 11 | ALBERT ABEDINI | |
| 12 | Zejnullah Gjzullah | |
| 13 | FATOS MEHMETI | |
| 14 | FITIM SALIHU | |
| 15 | Skender Ahmeti | |
| 16 | Smajl Salihu | |
| 17 | Gani Jashari | |

[illegible]

| | | |
|---|---|---|
| 18 | Ilir Fejzullahu | [signature] |
| 19 | Lulzim Mehmeti | [signature] |
| 20 | Sead Shabani | S8h. |
| 21 | Agron Mehmeti | [signature] |
| 22 | FADIL SHABANI. | [signature] |
| 23 | LAB. NOT ABEDINI | [signature] |
| 24 | NEXHAT FEJZULLAHU | [signature] |
| 25 | | |
| 26 | | |
| 27 | | |
| 28 | | |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |
| 36 | | |
| 37 | | |
| 38 | | |
| 39 | | |
| 40 | | |
| 41 | | |